



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0021659-7/25 dt. 28.04.2025

Mitrovicë



Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, dhe nenin 40, paragrafi 2, nënparagrafi c, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenit 9, paragrafi 7, të Ligjit Nr. 08/L-332 Mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 (GZ Nr. 22/12 dhjetor 2024,); neneve 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe 46, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, të Statutit të Komunës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 28.04.2025, pasi shqyrtoi Kërkesën Nr.02-400/01-0023803/25 dt. 24.04.2025 Për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 dhe viteve paraprake në buxhetin e vitit 2025, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0021658-4/25, dt. 25.04.2025), sjell këtë:

VENDIM

Për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 dhe vitet paraprake në buxhetin e vitit 2025

1. MIRATOHET Vendimi për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 dhe vitet paraprake në buxhetin e vitit 2025.
2. Shuma e mjeteve të bartura sipas pikës 1. të këtij Vendimi është 867,555.29 €.
3. Nga Shuma e cekur në pikën 2 të këtij Vendimi, shuma prej 5,000.00€ destinohet për kategoritë e shpenzimeve Paga dhe Shtesa, në programet/nënprogramet Arsimi i Mesëm (94830).
4. Nga Shuma e cekur në pikën 2 të këtij Vendimi, shuma prej 295,000.00,€ destinohet për kategoritë e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime, në programet/nënprogramet:
 - 4.1 Buxhet dhe Financa (17522), në vlerë 100,000.00 €;
 - 4.2 Zhvillimi Ekonomik (48022) në vlerë 50,000.00 €;
 - 4.3 Shërbimet Kulturore (85022) në vlerë 115,000.00 €;
 - 4.4 Arsimi Parafillor (92630) në vlerë 22,000.00 € dhe
 - 4.5 Arsimi i Mesëm (94830) në vlerë 3,000.00 €.
5. Nga Shuma e cekur në pikën 2 të këtij Vendimi, shuma prej 159,594.79 € destinohet për kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere, në nënprogramet:
 - 5.1 Shërbimet Sociale (75606), në vlerë 30,000.00 € dhe
 - 5.2 Shërbimet Kulturore (85022), në vlerë 129,594.79 €.
6. Nga Shuma e cekur në pikën 2 të këtij Vendimi, shuma prej 407,960.50 € destinohet për kategorinë e shpenzimeve Shpenzime Kapitale, në nënprogramet:
 - 6.1 Zhvillimi Ekonomik (48022), në vlerë 284,145.00 € dhe
 - 6.2 Administrata e Arsimit (92110), në vlerë 63,260.50 €.
 - 6.3 Administrata e Shëndetësisë (73031), në vlerë 60,555.00 €.
7. Pjesë e këtij Vendimi është tabela Nr. 1. Shpërndarja sipas programeve buxhetore dhe tabela Nr. 4.2 Lista e projekteve kapitale.
8. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
9. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesueses së Kuvendit

1 x 1 MAPL

1 x 1 Arkivi

Kopje: Kryetarit të Komunës

Të gjitha drejtorive



Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA